



GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje Ekonomike, gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, me bashkëpunëtoren profesionale Yllka Pajaziti Abdullahu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit NTTSH G... Sh.p.k. me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat D.R. me seli të zyrës në Kaçanik, kundër të paditurave: 1. Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) me seli në Prishtinë, Rr. Lidhja e Pejës p.n. të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Juristja D.S., dhe 2. NTP K... me seli në Carralevë – Shtime, me pronar D.F., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Sh.S. me seli të zyrës në Lipjan, për shkak të padisë për kompensim dëmi nga aksidenti i trafikut, në seancën e datës 26.01.2023 (hartuar me datë 03.02.2023) mori këtë:

#### A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET E TËRHEQUR padia e paditësit NTTSH G... Sh.p.k. me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat D.R., kundër të paditurës së parë Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) me seli në Prishtinë.
- II. OBLIGOHET paditësi NTTSH G... Sh.p.k. që t'ia kompensojë të paditurës së parë Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) me seli në Prishtinë shpenzimet e shkaktuara në këtë procedurë, në lartësi 150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro), në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

#### A r s y e t i m

Paditësi NTTSH G... Sh.p.k. përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar padi pranë gjykatës kundër dy të paditurave si në hyrje të këtij vendimi, për kompensim të dëmit nga aksidenti i shkaktuar në trafik i datës 07.02.2008.

Gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor e deri në përfundim të të njëjtit, pas nxjerrjes së provave me ekspertizat përkatëse, paditësi me të paditurën e dytë NTP K... në seancën e datës 26.01.2023 kanë lidhur ujdë gjyqësore për kompensim të dëmit. Ndërkaq ndaj të paditurës së parë BKS, paditësi e ka tërhequr padinë në tërësi për kompensim dëmit meqë nuk ka qenë e detyrueshme për pronarin e makinerisë së rëndë / mjeti i dëmtuar, që ta regjistrojë dhe sigurojë të njëjtin sipas

dispozitave të zbatuara – nga çka edhe nuk provohet përgjegjësia ligjore e BKS-së për kompensim.

E paditura e parë BKS nuk e ka kundërshtuar tërheqjen e padisë ndaj saj mirëpo ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve të shkaktuara për nxjerrje të ekspertizës nga lëmi i komunikacionit në lartësi 150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro).

Paditësi e ka kundërshtuar me deklaram në seancën gjyqësore të datës 26.01.2023 kompensimin e shpenzimeve të kërkuara nën arsyetimin se nxjerrja e provës me ekspertizë është propozuar nga vetë e paditura BKS andaj edhe e njëjta duhet t'i përballojë këto shpenzime.

Gjykata mori parasysh deklaramet e paditësit dhe të paditurit të parë, dhe pas shqyrtimit të të njëjtave vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi – pika I e dispozitivit, konform nenit 261 të Ligjit për procedurën Kontestimore (LPK), pasi që nënkuptohet mungesa e interesit juridik për t'u trajtuar padia ndaj të paditurit të parë (dhe u lidh ujdj gjyqësore me të paditurën e dytë për kompensimin e dëmit).

Sa i përket vendosjes për shpenzimet në procedurë të të paditurit BKS, gjykata vlerësoi se nxjerrja e provës me ekspertizën e propozuar nga e paditura e parë i ka shërbyer procesit kontestimorë për ndarjen e përgjegjësisë së kontributdhënësve në shkaktimin e aksidentit, dhe mbi bazën e këtyre të gjeturave palët – paditësi dhe e paditura II kanë lidhur ujdj gjyqësore.

Vlen të theksohet se ekspertiza nga lëmi i komunikacionit e punuar nga eksperti Sejdi Berisha, e datës 02.11.2022, e nxjerrë përgjegjës sekondar paditësin (punëtorin e tij si ngasës të mjetit motorik pjesëmarrës në aksident). Nga ky arsyetim, konform dispozitës nga neni 456 par. 1 dhe neni 463 par. 1 të LPK-së, Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktvendimi.

Gjykata vendosi në tërësi për këtë çështje me aktvendim, konform nenit 147 të LPK-së, meqë çështja kontestimore mes paditësit dhe të paditurës së dytë është zgjidhur përmes ujdisë gjyqësore të datës 26.01.2023.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 1/22, datë 03.02.2023

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesë e veçantë vetëm sa i përket pikës II të dispozitivit të këtij aktvendimit në afat prej 7 ditësh [konform nenit 509 pika c). e LPK-së], nga data e pranimit të aktvendimit, për Dhomat e shkallës II të Gjykatës Komerciale të Kosovës – përmes kësaj gjykate.